

UDHËZUES PËR SHQYRTIMIN DHE RISHIKIMIN E SYLLABUSIT

PËR MËSIMDHËNËSIT DHE PERSONELIN QË E MBËSHTET
DHE MBIQYRË ZHVILLIMIN E KURRIKULËS




**UDHËZUES PËR SHQYRTIMIN DHE RISHIKIMIN E SYLLABUSIT
PËR MËSIMDHËNËSIT DHE PERSONELIN QË E MBËSHTET
DHE MBIKËQYRË ZHVILLIMIN E KURRIKULËS**

Zhvilluar nga një grup punues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” /Zyra për Zhvillim Akademik dhe Pro Rektori për Sigurim të Cilësisë në bashkëpunim me Projektin HERAS –Arsimi i Lartë, Hulumtimi dhe Shkencat e Aplikuara në Kosovë

Prishtinë, Maj 2018

IMPLEMENTING CONSORTIUM



HYRJE

Ky udhëzues i shkurtër e mbështet stafin akademik/mësimdhënësit që t'i shkruajnë/shqyrtojnë/rishikojnë plan-programet e tyre në mënyrë adekuate që ta reflektojnë më mirë përmbajtjen e lëndës dhe metodologjitë e aplikuara. Qëllimi i të shkruarit të një syllabusi të mirë dhe cilësor është që t'u ofrojë studentëve informata lidhur me përmbajtjen e një lënde dhe elementët kryesorë të saj: qëllimi dhe synimi i lëndës, rezultatet e të nxënit, ngarkesa e studentëve, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies, metoda e vlerësimit dhe materialet mësimore. Kjo u mundëson studentëve që t'i përzgjedhin lëndët e përshtatshme dhe të përgatiten për to - ata do të dinë se çfarë mund të presin nga lënda dhe çfarë mund të pritet nga ata si studentë. Studentët do të jenë të vetëdijshëm për ngarkesën e punës që i pret për ta zotëruar lëndën, si dhe për rezultatet e pritshme të nxënies dhe kompetencat që ai/ajo do t'i fitojë pas përfundimit të lëndës. Studentët duhet të pajisen me këto informata në mënyrë që të marrin më shumë përgjegjësi gjatë mësimit të tyre individual. Në të njëjtën kohë, një plan-program i përgatitur mirë do të shërbejë si udhëzues për të gjithë personelin akademik/mësimdhënësit që janë të përfshirë në zbatimin e lëndës.

Përshkrimet/plan-programet e lëndëve të cilat janë të kuptueshme për studentët do të rezultojnë me shkallë më të ulët të braktisjes së studimeve, meqenëse studentët do të mund të marrin një vendim më të informuar lidhur me atë se cila është lënda e duhur për ta. Ata, po ashtu, mund të përgatiten më mirë dhe të marrin pjesë në lëndët që ata i kanë zgjedhur. Studentët që nuk e dinë se çfarë po ndodh me lëndët e tyre shpesh janë të zhgënjyer dhe frustrohen. Kjo sjellë një shkallë më të lartë të braktisjes së studimeve, prandaj reflekton keq në personelin e mësimdhënësve, në universitetin dhe përfundimisht rezulton me të diplomuar që janë të përgatitur dobët.

ÇFARË DUHET TË PËRMBAJË SYLABUSI

Sigurohuni që të gjitha pjesët të plotësohen dhe që sylabusi të përmbajë informata të mjaftueshme dhe të dobishme për lexuesit e jashtëm që të jenë në gjendje ta kuptojnë konceptin dhe përmbajtjen e lëndës.

I. Sylabusi duhet të hartohet sipas formularit zyrtar të lëshuar nga institucioni ¹

Aktualisht, formulari i sylabusit i përfshinë elementet kyçe si në vijim:

- Informatat themelore për lëndën: njësinë akademike me të cilën ndërlidhet lënda, titullin e lëndës, nivelin e studimeve, statusin e lëndës (p.sh. i obligueshëm), vitin e studimeve, numrin e orëve të mësimit në javë, kreditë ECTS, kohën/vendin, emrin dhe të dhënat kontaktuese të mësimdhënësit.
- Për lëndën: përshkrimi i lëndës, qëllimet e lëndës, rezultatet e pritshme të nxënies, rëndësia dhe aktualiteti i lëndës, prerekuiziti (nëse lënda ka si parakusht lëndë/detyrim paraprak).
- Ngarkesa e studentëve: duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies të studentëve.
- Metoda e mësimdhënies.
- Metoda e vlerësimit.
- Literatura (primare/e kërkuar dhe ajo shtesë/e rekomanduar).
- Hartimi i planit mësimor/njësive mësimore (15 javë për një semestër).
- Politikat akademike dhe kodi i sjelljes.

II. Përshkrimi i lëndës

Përshkrimi i lëndës duhet të jetë i shkurtër, konciz, i qartë dhe informues. Mendoni se çfarë duhet të dinë studentët/kolegët (dhe jo çfarë ju doni t'u tregoni).

III. Qëllimet e lëndës

Qëllimet pasqyrojnë perspektivën e mësimdhënësit dhe duhet të korrespondojnë me objektivat e përgjithshme të programit akademik dhe nivelin e studimeve (nivelet Bachelor, Master dhe PhD).

IV. Rezultatet e nxënies

(shih po ashtu: Hyland, A.; Kennedy, D.; Ryan, N.; Writing and Using Learning Outcomes. A Practical Guide: http://www.fibaa.org/fileadmin/uploads/content_uploads/Writing_and_Using_Learning_Outcomes_01.pdf (Synohet) Rezultatet e të nxënies përshkruajnë perspektivën e studentit për atë se çfarë pritet nga ai/ajo të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të suksesshëm të procesit të nxënies. Për t'i shkruar rezultatet e të nxënies rekomandohet të ndiqni taksonominë e Bloom-it (Shtojca II), e cila ofron një listë të foljeve për nivelet vijuese të të nxënies: njohuritë, kuptimin, aplikimin, analizën, sintezën, vlerësimin.

Në aspektin ideal, rezultatet e të nxënies duhet:

- Të jenë të shkurtra dhe precize.
- Të përmbajnë vetëm 1-2 folje veprorë në kuadër të rezultateve të nxënies.
- Të jenë të matshme. Disa njësi mësimore është më lehtë të maten se disa tjera, por të gjitha njësitë mësimore duhet të shkruhen mbi bazën e asaj se mund të vlerësohen në fund, prandaj kur i shkruani rezultatet e nxënies mendoni në atë se si mendoni ti vlerësoni ata në provim/në fund të lëndës.

¹ Ju lutemi ta keni parasysh që mostra për përshkrimin e sylabusit mund të ndryshohet kohë pas kohe.

Nëse rezultatet e të nxëniet i përfillin pikat e cekura më lartë, ato do ta pasqyrojnë më mirë se çfarë kompetencash do t'i fitojnë studentët pas përfundimit të lëndës.

V. Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës

Të informohet studenti për përfitimet që i ka nga mësimi i lëndës. Të paraqitet aktualiteti i lëndës në rrjedhat e reja dhe aktuale shoqërore, ekonomike, teknologjike, arsimore, etj.

VI. Ngarkesa e studentit

(shih po ashtu ECTS User's Guide, 2015:

https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/ects-users-guide_en.pdf)

“Ngarkesa e studentit” nënkupton kohën që zakonisht u nevojitet studentëve për t'i realizuar të gjitha aktivitetet e të nxëniet që kërkohen për t'i arritur rezultatet e pritshme të lëndës. Pra, llogaritja e ngarkesës së punës duhet të përfshijë komponentët vijuese: praninë dhe kontributin gjatë ligjëratave, punën në projekte, punën praktike/praktikën e detyrueshme, detyrat e shtëpisë dhe mësimin individual, si dhe përgatitjen për provime.

Llogaritja e kredive ECTS: Në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” një ECTS është e barabartë me 25 orë (të llogaritura) të punës që e bënë studentin. Në kuadër të kësaj, është e obligueshme që të përfshihet edhe puna individuale/koha e të mësuarit (mësimi individual) i studentit kur llogaritet numri i kredive ECTS (jo vetëm orët mësimore/prania e personelit të mësimdhënësve)!

Shembull

Një lëndë prej 4 ECTS/100 orë pune mund të llogaritet si në vijim:

- *Orë mësimi me mësimdhënësin: ligjëratat 2orë/në javë x 15 javë/një semestër = 30 orë; konsultimi me mësimdhënësin: 5 orë*

- *Koha e studentit për mësim individual (e llogaritur): puna në projekt = 30orë; detyrat e shtëpisë dhe mësimi individual = 15 orë; përgatitja për provime = 20 orë*

VII. Metodologjia e mësimdhënies

Duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet e mundshme për t'i arritur rezultatet e të nxëniet të lëndës. Nga ju kërkohet që t'i paraqitni saktësisht se cilat metoda të mësimdhënies/nxënies do t'i aplikoni, dhe, po ashtu, kërkohet që të mos përdorni pohime të përgjithësuara si për shembull “do të jetë një përzierje e ligjëratave dhe punës praktike”. Në vend të kësaj, bëjeni një përzgjedhje nga një numër i madh i metodave/aktiviteteve, siç janë: luajtja e roleve, rastet studimore, ushtrimet, prezantimet e studentëve, prezantimet e posterëve, puna në grupe, ditari i mësimit për të reflektuar lidhur me nxënien, ligjëratat, etj. (në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës). Aktivitetet dhe metodat duhet të jenë të orientuara nga studenti në mënyrë që të sigurohet që studentët të zhvillojnë kureshtjen, të menduarit kritik dhe shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve.

VIII. Metodologjia e vlerësimit

Duhet të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme dhe shpesh (e jo të përqendrohet vetëm në provimin final) për t'i inkurajuar studentët që të ndjekin dhe të marrin pjesë në lëndë në mënyrë aktive gjatë tërë vitit dhe nota përfundimtare duhet të jetë shuma e të gjitha rezultateve të studentit gjatë tërë lëndës (pjesëmarrja, angazhimi, detyrat e shtëpisë, provimet gjatë semestrit, provimi final).

IX. Literatura

Studentëve duhet ofruar material përkatës për lexim dhe duhet përfshirë më shumë edhe në çështjet/publikimet aktuale; prezantimi i materialit duhet të jetë i shkurtër dhe preciz dhe bëjeni dallimin ndërmjet asaj se çfarë ata duhet të lexojnë për ta kaluar lëndën (literatura primare/e rekomanduar) dhe materialet shtesë për lexim (literatura shtesë/e rekomanduar për studentët e shkëlqyeshëm apo të motivuar).

X. Plani mësimor (15 javë për semestër)

Plani i mësimdhënies duhet të jetë i detajuar për çdo javë veç e veç, duhet të përmbajë disa informata themelore, siç janë: tituj të njësive të lëndës; aktivitetin e pritshëm për përfshirjen e studentit; orët e planifikuara mësimore duhet t'u japin më shumë hapësirë studentëve për aktivitete të ndryshme, siç janë: ushtrimet, prezantimet, projektet e vogla, seminarët, etj

XI. Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Listoni elementet që ju i konsideroni të rëndësishëm për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie/nxënie. Ju duhet t'i listoni jo më shumë se pesë elemente për ta arritur qëllimin tuaj dhe këto elemente duhet t'i përshtaten orës mësimore (p.sh. nëse ju ligjëroni në orë të pikturës, ju mund të kërkonte nga studentët që ta pastrojnë klasën para se ata të largohen, etj.).

Disa shembuj të mundshëm:

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme.

Shtojca I_ SHEMBULL

Titulli i lëndës: VIZATIMI I LIRË DHE ESTETIKA E HAPËSIRËS

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Vizatimi i lirë dhe estetika e hapësirës
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	1+3
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa S6 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	xxx
Të dhënat kontaktuese:	xxx

Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Vizatimit të lirë dhe Estetikës së hapësirës i studion format natyrore dhe objektet tri-dimensionale duke u bazuar në studimin e paraqitjes së vizatimit të lirë të vijës, perspektivës, dritës dhe hijes, formës dhe proporcionit. Studentët do ta fitojnë aftësinë që të vizatojnë/paraqesin objektet në mënyra të ndryshme, duke u mundësuar atyre ta vlerësojnë një ndërtesë ose objekt në bazë të elementeve formale - proporcionit, ngjyrës dhe materialeve - dhe mënyrën se si zgjidhja e problemit do të ndikojë në dizajnin e përgjithshëm të hapësirës. Arti i vizatimit është një akt i koordinimitndërmjet dorës, syrit dhe mendjes. Secili prej këtyre elementeve i nënshtrohet praktikës dhe rutinës, prandaj shumë studentë do ta përmirësojnë vizatimin e tyre thjesht duke i mësuar parimet dhe modelet e reja dhe të dobishme.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore i nënshtrohen shqyrtimit të qasjeve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në vizatim. Theksi do të vihet në zhvillimin e aftësisë së studentit për të parë dhe kuptuar se si të krijojë dhe paraqes hapësirën reale përreth formave të tyre të vërteta, si dhe t'i qaset dhe të zgjedhë teknikën më të përshtatshme për të krijuar një vizatim efektiv. Këto mundësojnë njohjen e studentit për ta kuptuar më lehtë të ashtuquajturën hapësirë arkitekturore.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:
	- Aplikoj raportin proporcional të vizatimeve duke përdorur matjet.
	- Demonstroj teknikat themelore të vizatimit të lirë.
	- Aplikoj parimet e vizatimit perspektiv me një, dy apo tri pika pakufi.
	- Aplikoj parimet e vizatimit të bazuar në hije, thellësi, teksturë.
	- Shqyrtoj raportet proporcionale ndërmjet objekteve.
	- Kombinoj kompozicionin efektiv me zhvillimin e stilit personal.
	- Definoj dhe artikuloj fjalorin dhe terminologjinë që përdorët në art.
- Define and articulate the vocabulary and terms used in art.	

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren	2	1	2
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			3
Përgatitja për provimin final			4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
-------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është X%. Vijueshmëria e studentit X%; Detyrat individuale të kryera në klasë X%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi X%; Vlerësimi nga testet X%; Provimi final X%.
-----------------------	--

Literatura primare:	1.Ligjëratat të përgatitura nga Prof.ass.dr.Arta Jakupi 2.Keys to Drawing, Bert Dodson, North Light Books, Cincinnati, Ohio,manufactured in USA, First edition, First paperback printing 1990
---------------------	--

Literatura shtesë:	1.White, G., (1989), Perspective-A Guide for Artist, Architects and Designers, BTBatsford Ltd, London Campanario, G., (1990), 2.The Art of Urban Sketching, Quarry Books, Beverly, MA 3.Wnag, Th. C., (2002), Pencil Sketching, 2nd Ed. John Wiley & Sons.Inc, New Y
--------------------	---

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në konceptet themelore dhe materialet që do të ligjërohen; Pajisjet dhe procedurat themelore të skicimit
Java 2:	Procesi i vizatimit
Java 3:	Vizatimi i lirë dhe i kontrolluar
Java 4:	Matja
Java 5:	Iluzioni i dritës
Java 6:	Iluzioni i thellësisë
Java 7:	Perspektiva një, dy dhe tre pikëshe
Java 8:	Perspektiva e elipsës dhe perspektiva e pikave pakufi 0, 4, 5, 6
Java 9:	Skicimi urban – teknikat - mjetet
Java 10:	Skicimi i njerëzve, pemëve, terrenit dhe elementeve tjera plotësuese të peizazhit arkitekturor
Java 11:	Skicimi i objekteve arkitekture
Java 12:	Skicimi i qytetit
Java 13:	Iluzioni i teksturës
Java 14:	Vizatimi dhe imagjinata
Java 15:	Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me detyrat në klasë dhe në shtëpi gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

Shtojca II. Lista e foljeve të Bloom-it për përpilimin e Rezultateve të Nxënies

Klasifikimi i shkathtësive kognitive sipas Bloom		
Kategoria	Përkufizimi	Sjelljet e ndërlidhura
Njohuritë	Të kujtosh apo të mbash mend diçka pa pasur nevojë ta kuptosh medoemos, ta përdorësh apo ta ndryshosh	Defino, përshkruaj, identifiko, emërto, listo, krahaso, mbaj mend, trego, rikujto, përzgjedh, poho
Të kuptuarit	Të kuptosh diçka që është komunikuar pa pasur nevojë që ta ndërlidhësh me diçka tjetër	Ndrysho, shpjego, jep shënime, kalkulo, ndrysho, shndërro, grupo, shpjego, përgjithëso, jep shembuj, konkludo, interpreto, parafrazo, parashiko, rishiko, përmbledh, përkthe
Aplikimi	Të përdorësh një koncept të përgjithshëm për t'i zgjidhur problemet në një situatë të caktuar; duke përdorë materialet që i ke mësuar në situata të reja dhe konkrete	apliko, mirato, mbledh, ndërto, demonstro, zbulo, ilustrro, intervistto, shfrytëzo, manipululo, ndërlidh, shfaq, zgjidh, përdor
Analiza	Të zbërthesh diçka në pjesë; mund të fokusohesh në identifikimin e pjesëve apo në analizën e marrëdhënieve ndërmjet pjesëve, apo njohjen e parimeve organizative	analizo, krahaso, ballafaqo, krijo diagram, bëje dallimin, copëto, dallo, identifiko, ilustrro, konkludo, skico, thekso, përzgjedh, ndajë, klasifiko, ndaj në pjesë më të imëta
Sinteza	Të ndërlidhësh diçka të re duke i bërë bashkë pjesët e ideve të ndryshme për të krijuar një tërësi.	përziej, ndërto, ndrysho, kombin, harto, harto, koncepto, krijo, dizajno, formulo, gjenero, supozo, planifiko, parashih, prodho, ri-renderit, rishiko, trego, shkruaj
Vlerësimi	Të gjykosh vlerën e materialit apo metodave se si mund të aplikohen në një situatë të caktuar; të gjykosh duke përdorë kritere të përcaktuara.	Prano, çmo, vlerëso, gjyko, shpërble, zgjidh, konkludo, kritik, mbroj, vlerëso, grado, gjyko, cakto prioritetet, rekomando, arbitro, refuzo, përzgjidh, përkrah.